



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Thirrje për aplikim për pjesëmarrje në

## Shkollën Verore 2022

**Tema: Promovimi i veprimeve për ndryshimet klimatike te të rinjtë kosovar**

Vendi: Hotel “Magra Austria” Bogë, Pejë

Koha e mbajtjes: 27 – 29 Maj, 25 qershor, 2 korrik dhe 24 – 30 Korrik 2022

Asociacioni Kosovar për Energji të Ripërtëritshme dhe Efiçencë të Energjisë (AKEREE), në partneritet dhe me financim nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim, Ambasada e Zvicrës, organizon për herë të gjashtë radhazi Shkollën Verore për energji dhe klimë. Andaj, ftohen kandidatët e interesuar nga e tërë Kosova, që të marrin pjesë në këtë shkollë. Programi do të zhvillohet në gjuhën shqipe dhe do të zbatohet nga AKEREE duke angazhuar ekspertë me përvojë në fushën e energjisë, përkatësisht në ndryshimet klimatike, në fushat e EE, BRE dhe biodiversitetit.

Programi i shkollës verore ofron një mundësi të mirë për të marrë njohuri në fushën e ndryshimeve klimatike që përfshinë efiçencën e energjisë (EE) dhe burimet e ripërtëritshme të energjisë (BRE), biodiversitetin, planifikimin, etj. Programi është i përpiluar për studentët që planifikojnë të merren me fushën e energjisë, mbrojtjen e mjedisit si dhe burimeve të ripërtëritshme të energjisë – Lider të së ardhmes. Ky program do të jetë një mundësi e mirë për studentët që të zhvillojnë njohuritë e tyre dhe të rritin bashkëpunimin duke krijuar ura komunikimi në mes profesioneve të ndryshme, gjithnjë duke e konsideruar energjinë secili nga aspekti i profesionit të tij.

Ideja kryesore e projektit të shkollës verore është për të krijuar një hapësirë të lirë edukimi, në të cilën studentët do të marrin njohuri dhe në mënyrë aktive mund të shkëmbejnë informatat dhe përvojat që lidhen me ndryshimet klimatike, EE, BRE, etj. Çështja e ndryshimeve klimatike gjithnjë e më shumë po bëhet çështje ndërkombëtare dhe e bashkëpunimit interdisiplinar. Prandaj, shumë përfitime mund të dalin nga bashkëpunimi në mes profesioneve të ndryshme.

Kandidatët e interesuar për pjesëmarrje në shkollën verore duhet:



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

- Të jenë studentë në vitin e fundit të studimeve në nivelin bachelor ose të jenë duke vijuar studimet master në shkencat teknike, arkitekturë, ekonomi, menaxhment, shkenca të natyrës, ekologji, shkenca politike, juridik dhe të ngjashme.
- Të kenë njohuri në programet kompjuterike Microsoft Office si Word, Excel dhe Power Point. Gjithashtu duhet të ketë edhe njohuri për punën me internet.

Shkolla Verore për Energji dhe Klimë do të organizohet në disa pjesë: pjesa e parë përfshin mbajtjen e ligjëratave interaktive dy ditore në klasë. Pjesa e dytë do t'i ndihmoj pjesëmarrësit në krijimin e njohurive më të mira me biodiversitetin përmes ecjes së organizuar (hiking) në natyrë dy ditë ndaras. Ndërsa pjesa e tretë (ngjarja kryesore) përfshin ligjërata dhe diskutime të cilat e përbëjnë pjesën teorike dhe do të mbahen përgjatë sesioneve të paradites. Po ashtu, do të jetë edhe pjesa e punës në grupe e cila do të organizohet përgjatë sesioneve të pasdites.

Grupet punuese do të trajtojnë një temë e cila do të i 'u përcaktohet studentëve pjesëmarrës paraprakisht në ditën e parë të shkollës. Tema përkatëse do të trajtohet nga grupet punuese përgjatë pesë ditëve të shkollës verore. Një ditë në kuadër të kësaj ngjarje do të organizohet vizite studimore në një projekt me emision të ulët. Në përfundim të shkollës do të shpërndahen certifikata për pjesëmarrjen.

Për të aplikuar, kandidatët ose kandidatet e interesuar/a për pjesëmarrje në shkollën verore duhet të dërgojnë:

- CV-n e tyre,
- Kopjen e letërnjoftimit,
- ID kartelën e studentit, dhe
- një letër motivuese e cila do të tregojë njohuritë në fushën e energjisë e mjedisit jetësor si dhe motivin e tyre për pjesëmarrje në shkollë.

Me qëllim të zbatimit të vendimit të Qeverisë së Kosovës (i datës 30.04.2022) lidhur me masat për parandalimin e COVID-19, kandidatët që aplikojnë duhet të dëshmojnë:

- Certifikatën e vaksinimit me më së paku dy doza ose një dozë të vaksinës Janssen kundër COVID-19;
- Personat me dëshmi mjekësore nga mjeku specialist i fushës përkatëse se kanë kundërrindikacione dhe janë të liruar nga vaksinimi, duhet të posedojnë testin RT-PCR negativ për COVID 19 jo më të vjetër se një javë.

Numri i pjesëmarrësve është i kufizuar.

Në rast të aplikimit të kandidatëve/kandidateve me kualitete të barabarta, përparësi do të kenë ata/ato që kanë aplikuar më herët në kohë.

Po ashtu, pjesëmarrësit nga vitet e kaluara të Shkollës Verore të organizuar nga AKEREE, nuk mund të marrin pjesë këtë vit.

Kjo është një mundësi e barabartë për të gjithë, mirëpo inkurajohet pjesëmarrja e studentëve të gjinisë femërore.

Aktivitetet e shkollës mbahen në gjuhën shqipe, por njohja e Gjuhës Angleze është e preferueshme.



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Koha e aplikimit është prej datës **05 deri me 12 maj 2022**, në fund të ditës kalendarike.

Dokumentacioni për aplikim të dërgohet në adresën elektronike: [akeree@gmail.com](mailto:akeree@gmail.com)

Për kandidatët/et e pranuar, shpenzimet për qëndrimin në hotel, ushqimi dhe vijimi i shkollës janë të mbuluara nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim, Ambasada e Zvicrës, ndërsa është i siguar edhe transporti pa pagesë për pjesëmarrësit, në relacionin: Prishtinë – Pejë – Hotel “Magra Austria”- Bogë, dhe kthimi i pjesëmarrësve pas mbarimit të shkollës verore. Varësisht prej cilit rajon do të jenë studentët e pranuar, ata me shpenzimet e veta duhet të udhëtojnë deri në Prishtinë, apo Pejë. Për këtë qëllim është i siguar një autobus që do t’i merr studentët së pari në Prishtinë, pastaj në Pejë dhe për të arritur në hotelin “Magra Austria”- Bogë, ku do të bëhet organizimi i shkollës verore.

Për çfarëdo informacioni shtesë mund të kontaktoni në numrin e tel. + 383 44 413 241, çdo ditë pune prej orës 17:00 deri në ora 21:00, apo në adresën elektronike: [akeree@gmail.com](mailto:akeree@gmail.com)